



Tiranë më

Nr.

protnumber

**RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR**

**CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME
VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, PËR DISA NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE,
TË DATËS 9 NËNTOR 2025**

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendin e Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Referuar vendimit nr. 3, datë 09.02.2021 neni 4, pika 4 të Komisionit Rregullator “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë së 40 ditë nga data e zgjedhjeve cakton me vendim Vendin e Numërimit të Votave për çdo ZAZ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës 6338, datë 17.10.2025, i është drejtuar Prefektëve të Qarqeve, duke i sjellë në vëmendje afatin ligjor për paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut përkatës, të cilët përmbushin kriteret e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në Vendimin nr. 3, datë 09.02.2021 të Komisionit Rregullator “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendi të Numërimit të Votave”.



Prefektët qarqeve, për bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhet, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 94 të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur në KQZ listën e objekteve brenda territorit të qarkut përkatës. Për çdo objekt është referuar mjedisi ku mund të caktohet VNV-ja dhe është paraqitur planimetria e tij.

Nga shqyrtimi i të dhënave të objekteve të paraqitura, rezulton se objektet dhe mjediset përkatëse përmbushin kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 09.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”:

- janë salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive;
- plotësojnë kriterin teknik të sipërfaqes bazuar në numrin e QV-ve të ZAZ-së;
- përgjithësisht, janë brenda territorit të ZAZ-ve;
- ofrojnë lehtësi logjistike të transportit rrugor nga QV-të e ZAZ-së;
- ofrojnë kushte për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave;
- kanë sistem të pandërprerë të furnizimit me energji elektrike.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve të afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2028, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, paraqet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të vetëqeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”.

Erion	META	– Drejtoria e Administratës Zgjedhore
Pavlina	DOÇAJ	– Drejtoria e Ligjshmërisë
Jona	Josifi	– Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

protnumber

Data: xxxxxxxx

Nr: xxx

Ora: xxxx

VENDIM
PËR
CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, PËR DISA NJËSI TË
VETËQEVERISJES VENDORE, TË DATËS 9 NËNTOR 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 93, pika 1, dhe nenit 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave”,

V E N D O S:

1. Caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
E. Mema _____
E. Dushallari _____
E. Meta _____
P. Doçaj _____
J. Josidi _____

Data: xxxxx Nr: xxx
Ora: xxxx



Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të vetëqeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025

Lidhja nr. 1

Bashkia	KZAZ	Nr. QV	Objekti i propozuar për VNV	Sipërfaqja
Mat	16	47	Pallati i Sportit “Ferit Hysa”	641 m ²
Cërrik	47	58	Palestra e Shkollës 9-vjeçare “Aleks Buda”, Cërrik	190 m ²
Berat	66	72	Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”, Berat	363 m ²
	67	43	Ambienti i Bibliotekës “Vehxhi Buharaja”, Berat	760 m ²
Tepelenë	80	22	Qendra Kulturore, Tepelenë	120 m ²
Vlorë	84	68	Palestra e shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali” Vlorë	460 m ²
	85	52	Palestra e gjimnazit “Ali Demi” Vlorë	520 m ²
	86	54	Pallati i Sportit “Flamurtari” Vlorë	1600 m ²
	87	57	Pallati i Sportit “Flamurtari” Vlorë	1600 m ²

Data: xxxxx Nr:xxx
Ora: xxx



Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të vetëqeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025